

Vendim nr. 186, datë 04.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 04.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ADRIATIK VELAJ**, përfaqësuar nga avokati Saimir Vishaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 34, datë 26.05.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 1, datë 04.01.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 31, 33, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi rezulton se ka ushtruar detyrën e drejtorit të Mbrojtjes së Zjarrit dhe Shpëtimit, Durrës. Po kështu, rezulton se ndaj tij është depozituar kallëzim penal nga shtetasi F.T., me detyrë “oficer/inspektor” pranë së njëjtës drejtori, për kryerjen nga kërkuesi të veprave penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 244 e 248 të Kodit Penal (KP). Në kallëzim referohej realizimi i një tenderi të dyshimtë për blerjen e një mjeti zjarrfikëse shkallë.

2. Pas hetimeve, organi i akuzës i ka kërkuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) dërgimin për gjykim të çështjes ndaj disa të pandehurve, midis të cilëve edhe kërkuesi, dhe disa shoqëri tregtare. Me vendimin e datës 05.04.2022 është pranuar kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim. Gjatë shqyrtimit në themel, të gjithë të pandehurit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, kërkesë e cila u pranua nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, duke vendosur që çështja të gjykohej sipas kësaj procedure, pasi u vlerësua se mund të zgjidhej mbi bazën e akteve ekzistuese në dosje.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 34, datë 26.05.2022, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, dhe dënimin e tij me 1 (një) vit e 5 (pesë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkuesit i është ulur 1/3-ta e masës së dënimit, për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar, dhe përfundimisht është dënuar me 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 10 (dhjetë) ditë burgim [...]. Ndalimin e së drejtës së kërkuesit për ushtrimin e funksioneve publike për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.”. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim, ndër të tjerë, edhe kërkuesi.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 1, datë 04.01.2023, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.34, datë 26.05.2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs, ndër të tjerë, edhe kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-1978, datë 23.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, në lidhje me deklarimin fajtor tej çdo dyshimi të arsyeshëm, GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 258 dhe 190/2 të KP-së, në raport me veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarve dhe të provave të administruara në gjykim, si dhe ka marrë në analizë, referuar neneve 47 e vijues të KP-së, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të kryerjes së

veprës për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, pretendimet e të gjykuarve, përfshirë kërkuesin, i referohen kryesisht vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit, objekt i cili nuk hyn në vlerësimin që Gjykata e Lartë i bën çështjes së rekursuar. Po kështu, sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në mënyrë të drejtë e ligjore vendimmarrjen e saj, duke evidentuar faktin penal, veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarve në raport me elementet e veprave penale për të cilat ata janë akuzuar dhe provat e administruara në gjykim, duke mos u dhënë asnjërës prej tyre vlerë të paracaktuar. Në përfundim, Kolegji Penal ka arsyetuar se e gjen të drejtë arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, duke vlerësuar gjithashtu se ajo gjykatë i ka vlerësuar drejt provat e paraqitura nga organi i akuzës për sa i përket standardit të provueshmërisë në procesin penal tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të prezumimit të pafajësisë.

6. Në datën 20.02.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 18.03.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se:

7.1. Është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi nuk është provuar fajësia e kërkuesit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor, përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit.

7.2. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave të paraqitura për shqyrtim dhe nuk ka respektuar institutin e çmuarjes së provave, sipas nenit 152 të KPP-së. Gjatë gjykimit nuk është provuar se kërkuesi ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë ka kontradikta në analizën e tij dhe në paraqitjen e rrethanave dhe të fakteve, të cilat nuk i ka bazuar në provat e gjykimit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka arsyetuar se përse kërkuesi ka refuzuar të marrë në dorëzim mjetin, pasi ka konstatuar parregullsinë e tij. Nuk ekziston asnjë provë që kërkuesi të ketë konsumuar elementet e veprës penale për të cilën është dënuar.

7.3. Gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin material penal, pasi nga tërësia e akteve të administruara në gjykim nuk rezulton që kërkuesi të jetë subjekt i veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së, për shkak se ai nuk ka kryer asnjë veprim në

kundërshtim me detyrën e tij të parashikuar në ligj, dhe aq më tepër që me veprimet ose mosveprimet e tij të ketë sjellë pasoja ndaj interesave të shtetit. Arsyetimet e gjykatave për deklarimin fajtor të kërkuesit janë në kundërshtim logjik dhe ligjor me provat e administruara. Gjatë gjykimit nuk është provuar që kërkuesi të ketë përfituar të mira materiale dhe cili ka qenë veprimi konkret i tij që ka sjellë, si pasojë, dëmin e interesave të ligjshëm të shtetit.

- 7.4. Gjykatat në identifikimin e përgjegjësisë së kërkuesit për kompetencat e tij për hartimin e fondit limit kanë keqinterpretuar dhe keqzbatuar ligjin, pasi në arsyetimin e tyre nuk kanë referuar përcaktimet e udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrave të parashikimit të prokurimit publik, e regjistrave të realizimit të procedurave të prokurimit publik dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit publik”. Në rastin konkret, nga ana e kërkuesit nuk ka asnjë tejkallim me dashje kriminale të kompetencave të tij ligjore, dhe as ushtrim të kompetencave të tij në kundërshtim me ligjin. Veprimet e kërkuesit mund të cilësoheshin si shkelje të natyrës administrative dhe jo veprime të kryera me dashje kriminale.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të

elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskalimin e saj në seancë plenare.

10. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Kolegji vëren se në thelb ai ka pretenduar se i është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi nuk i është provuar fajësia tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave dhe nuk është provuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën është dënuar, pasi nuk ekziston asnjë provë që të ketë konsumuar elementet e asaj vepre penale. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin material penal, e kanë keqinterpretuar atë, dhe arsyetimet e tyre për deklarimin fajtor të tij janë në kundërshtim logjik dhe ligjor me provat e administruara. Sipas kërkuesit, veprimet e tij mund të cilësoheshin si shkelje të natyrës administrative dhe jo veprime të kryera me dashje kriminale, pasi nuk është kryer asnjë veprim në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk është provuar që ai të ketë përfutur të mira materiale dhe cili ka qenë veprimi konkret që ka sjellë si pasojë dëmin e interesave të ligjshëm të shtetit.

11. Në lidhje me pretendimin e cenimit të *parimit të prezumimit të pafajësisë*, Kolegji konstaton se kërkuesi e ka lidhur atë vetëm me argumentin se nuk është provuar fajësia e tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh këto argumente të kërkuesit, Kolegji vëren se ndonëse ai ka barrën e provës për të provuar këtë pretendim të tij, për shkak të natyrës argumentuese të gjykit kushtetues, nuk ka parashtruar asnjë argument ose akt provues në këtë drejtim, duke ngelur, për këtë shkak, një pretendim me natyrë të përgjithshme dhe i pamjaftueshëm për të vënë në dyshim procesin gjyqësor në këtë drejtim ose për të provuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit e kanë nisur procesin me paragjykimin se kërkuesi e kishte kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar.

12. Për më tepër, rezulton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit vlerësimin e tyre e kanë mbështetur në provat e marra nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake, ndërmjet të cilave janë këqyrja e automjetit tip “zjarrfikëse” të blerë nga Bashkia e Durrësit; akti i ekspertimi autoteknik; këqyrja/sekuestrimi i dokumentacionit të plotë për procedurën e blerjes së automjetit tip “zjarrfikëse”; këqyrja e të dhënave që ofrohen nga faqja e QKB-së në lidhje me shoqëritë pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit; procesverbalet në lidhje me kontrollet e ushtruara në ambientet e selive ku kanë ushtruar aktivitetin shoqëritë tregtare të akuzuara për kryerjen e veprave penale; rezultatet e përgjimeve; të dhënat e përfutura

nga aktet e ekspertimit tekniko-kompjuterik për ekzaminimin e aparateve telefonike të sekuestruara të të pandehurve dhe kompjuterëve të sekuestruar në shoqëritë tregtare të akuzuara. Po kështu, Kolegji konstaton se ky pretendim i kërkuarit ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë, e cila, në ushtrimin e saj si gjykatë ligji, bazuar edhe në parimin e subsudiritetit, ka arsyetuar se e gjen të drejtë arsyetimin e GJKKO-së së Apelit dhe se ajo gjykatë i ka vlerësuar drejt provat e paraqitura nga organi i akuzës për sa i përket standardit të provueshmërisë në procesin penal përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të prezumimit të pafajësisë. Në lidhje me këtë të fundit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 248, 258 dhe 190/2 të KP-së (*shih paragrafin 5 të këtij relacioni*).

13. Për sa më lart, Kolegji evidenton se argumentet e kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur paragjykim nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit në shqyrtimin e çështjes së tij. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

14. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Kolegji konstaton se ato janë të natyrës së përgjithshme dhe, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi i provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme. Në vlerësimin e Gjykatës problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe të fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji vëren se për pretendimet e tjera të tij kërkuari nuk ka sjellë ndonjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe, në kushtet që ai nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime të tij mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues e nuk mund të merren në shqyrtim. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e tjera të paraqitura në ankimin kushtetues individual.

15. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji vlerëson se nuk është e nevojshme analiza e mëtejshme e plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues të individual të kërkesit.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.